f.a

# AKT THEMELUES
# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "AGRO-KONI" SH.P.K

Ky akt themelues u perpilua nga:

Ruzhdi Koni,i biri i Muhametit, i vitlindjes 1963, lindur ne Maminas e banues ne Tirane .me adrese Rruga "Pandi Dardha", p.2, shk.1, ap.1.
I quajtur me poshte Ortak i Vetem , ne perputhje me ligjin Nr.7632, date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregetar", me ligjin Nr.7638,date 19.11.1992 "Per Shoqerite tregetare", si dhe me aktet e tjera te legjislacionit qe trajtojne keto ceshtje, vendosi te hartoje kete akt themelimi si vijon:

## I. FORMIMI

1.1 Formimi i shoqerise

Ortaku i vetem Ruzhdi Koni formon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me kreun e katert te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare.

1.2 Emri

Emri i Shoqerise do te jete "AGRO-KONI"

1.3 Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise "AGRO-KONI" SH.P.K eshte si vijon:
Import-eksport te mallrave ushqimore, industriale, pije alkolike e freskuese, plehra kimike, kimikate, pesticide, farna te ndryshme,materiale ndertimi, makineri e pajisje dhe lende te para, tregetim me shumice e me pakice: grumbullim dhe shitje te prodhimeve bujqesore e blektorale; transport mallrash per nevojat e shoqerise dhe te treteve.

1.4 Adresa e shoqerise

Selia qendrore e perhershme e shoqerise do te jete ne adrese Rruga "Pandi Dardha", p.2, shk.1, ap.1.

Me vendim te Ortakut te vetem mund te hape dege, zyra , filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

1.5 Afati i shoqerise

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 20 vjet. Si date fillestare do te merret data e regjistrimit te saj ne Gjykaten e rrethit Tirane. Ortaku i vetem ka te drejte ta zgjase kete afat.

1.6 Ruajtja e sekretit

Ortaku i vetem dhe bashkepunetoret e vet nuk do t'i tregojne ndonje personi jashte shoqerise informacionet qe do te disponoje shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe si dhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhmen.

## II. KAPITALI

2.1 Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke ,teresisht i derdhur prej ortakut te vetem themelues.

2.2 Kontributet e kapitalit

Kapitali i percaktuar ne piken 2.1 te ketij Akti Themeltar do te quhet "Kontribut" Kapitali, kontribut ky i Ortakut te Vetem.

Ortaku i Vetem ka te drejte t'i beje shtese kapitalit te vet.

2.3 Financimi

Per aq sa do te jete e mundur shoqeria ka te drejte te siguroje financim tregetar ose investues nga cdo banke apo institucion financiar (i huaj apo shqiptar) . financim qe do te rregullohet me ane te kontratave apo marreveshjeve te posacme me miratimin e Ortakut te vetem.

2.4 Çeshtjet financiare dhe llogaria e shoqerise

Shoqeria do ti mbaje llogarite duke u mbeshtetur ne monedhen shqiptare dhe ne valuta te huaja. Per keto aresye ajo, ne banken me te cilen do te operoje do te kete dy llogari rrjedhese, njeren ne monedhen shqiptare (leke) dhe tjetren ne valute te huaj.

## III.STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

3.1.Organet e shoqerise

- Asambleja e ortakeve, funksion qe do te kryhet prej ortakut te vetem
- Administratori
- Ekspertet kontabel

3.2 Administrimi i shoqerise

- Detyren e administratorit te shoqerise.do ta kryeje ortaku te vetem i shoqerise. Ortaku i vetem mund te emeroje administrator jo ortak ne baze te ligjit.

## IV. DISPOZITE E FUNDIT

f@

4.1 Ndryshimet ne kete AKT mund te vehen vetem me shtese me shkrim dhe te miratuara nga ortaku i vetem themelues.

Pjese e pandare e ketij AKTI eshte Statuti i Shoqerise i cili nenshkruhet njekohesisht nga themeluesi i shoqerise.

4.2 Ky akt themelimi u hartua ne 4 kopje origjinale dhe nenshkruhet rregullisht konform ligjit para Noterit.

THEMELUESI
RUZHDI KONI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA
Nr....435.....rep. Nr....192.........Kol.

VERTETIM

Ne Tirane.sot me daten.26.12.1997, para meje Notere Manushaqe Sharko u paraqit personalisht: Ruzhdi Koni.i biri i Muhametit. i vitlindjes 1963. lindur ne Maminas e banues ne Tirane .me adrese Rruga "Pandi Dardha". p.2. shk.1. ap.1. me certifikate Nr.6-28-7. date 02.04.1997. madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar. i cili deklaroi se ka redaktuar jashte zyres se noterise kete akt themelimi , me vullnetin e tij te lire e nenshkruan rregullisht para meje dhe une Noter e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
Manushaqe Sharko

PULLE TAKSE
20 LEKE
R.SHQIPERISE

# STATUTI
# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "AGRO-KONI" SH. P .K

## KREU 1

## FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

### NENI 1

### F O R M A

Shoqeria "AGRO-KONI" SH.P.K me poshte e quajtur SHOQERI formohet nga Ortaku i Vetem themelues:

Ruzhdi Koni,i biri i Muhametit i vitlindjes 1963, lindur ne Maminas e banues ne Tirane ,me adrese Rruga "Pandi Dardha", p.2, shk.1, ap.1.

Shoqeria krijohet ne perputhje me ligjin Nr.7638, date 19.11.1992"Per shoqerite tregetare", ligjin Nr.7632, date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregetar".dhe si person juridik e fillon aktivitetin me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar.

### NENI 2
### EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i Shoqerise do te jete "AGRO-KONI" SH.P.K

### NENI 3
### SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne Tirane me adrese Rruga "Pandi Dardha", p.2, shk.1, ap.1.

Me vendim te ortakut te vetem mund te hape dege, zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

### NENI 4
### KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete kohezgjatje mbi 20 vjet. Si date fillestare merret data e regjistrimit te saj ne Gjykaten e rrethit Tirane.

f (a

# STATUTI
# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "AGRO-KONI" SH. P .K

## KREU I

## FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

### NENI 1

### FORMA

Shoqeria "AGRO-KONI" SH.P.K me poshte e quajtur SHOQERI formohet nga Ortaku i Vetem themelues:

Ruzhdi Koni.i biri i Muhametit i vitlindjes 1963. lindur ne Maminas e banues ne Tirane .me adrese Rruga "Pandi Dardha". p.2. shk.1. ap.1.

Shoqeria krijohet ne perputhje me ligjin Nr.7638. date 19.11.1992"Per shoqerite tregetare". ligjin Nr.7632. date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregetar".dhe si person juridik e fillon aktivitetin me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar.

### NENI 2
### EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i Shoqerise do te jete "AGRO-KONI" SH.P.K

### NENI 3
### SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne Tirane me adrese Rruga "Pandi Dardha". p.2. shk.1. ap.1.

Me vendim te ortakut te vetem mund te hape dege. zyra. filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

### NENI 4
### KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete kohezgjatje mbi 2O vjet. Si date fillestare merret data e regjistrimit te saj ne Gjykaten e rrethit Tirane.

## NENI 5
## OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise "AGRO-KONI" SH.P.K eshte si vijon "Import-eksport te mallrave ushqimore, industriale, pije alkolike e freskuese, plehra kimike, kimikate, pesticide, farna te ndryshme,materiale ndertimi, makineri e pajisje dhe lende te para, tregetim me shumice e me pakice; grumbullim dhe shitje te prodhimeve bujqesore e blektorale; transport mallrash per nevojat e shoqerise dhe te treteve".

## KREU II
## KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI

## NENI 6
## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, i cili eshte likujduar teresisht prej ortakut te vetem themelues te shoqerise.

## NENI 7
## KONTRIBUTET E KAPITALIT

Kapitali i percaktuar ne Nenin 6 te ketij statuti do te quhet "Kontribut" kapitali ky i ortakut te vetem.

Ortaku i vetem ka te drejte t' i beje shtese kapitalit te vet.

## NENI 8

## NDARJA E FITIMIT

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon Ortakut te Vetem.

## NENI 9
## LINJA E TRANSFERIMIT TE PJESEVE TE KAPITALIT

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem tek personat e trete ne qoftese Ortaku i Vetem vendos per kete. Gjithashtu ato jane lirisht te transferuesheme ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ne rruge trashegimie. Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial.

## KREU III

## STRUKTURA JURIDIKE, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### NENI 10
### ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise do te jene:

- Asambleja e Ortakeve, funksion qe do te kryhet prej ortakut te vetem.
- Administratori
- Ekspertet kontabel.

### NENI 11
### ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Atributet e Asamblese do te kryhen nga Ortaku i vetem, i cili miraton llogarite pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, merr vendim per ndryshimet qe mund te pesoje statuti, per ndryshimin e mases se kapitalit fillestar dhe shendrimin e shoqerise ne nje forme tjeter, per punesimin ne baze te Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise. Ortaku i vetem mund t'i delegoje kompetencat e tij. Vendimet e marra prej tij evidentohen ne nje regjister.

### NENI 12
### FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Fusha e autoritetit te Ortakut dhe perqindja e fitimeve ose humbja do te kete si kriter baze kapitalin e shoqerise , si dhe kompetencat qe gezon ne marrjen e vendimeve te cdo karakteri te percaktuara ne kete statut.

### NENI 13

Te gjitha aktet dhe dokumentet qe nxirren nga shoqeria dhe te destinuara per te tretet, si dhe letrat, faturat, lajmerimet dhe publikimet e tjera duhet te tregojne lexueshem emrin e SHOQERISE, dhe pas tij fjalet "Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose inicialet SH.P.K

### NENI 14
### ADMINISTRIMI

Shoqeria administrohet nga nje administrator funksion qe kryhet nga ortaku i vetem. Ne rast se zgjerohet aktiviteti i shoqerise, si edhe ne rast se ortaku i vetem nuk deshiron ta ushtroje kete funksion, ai merr vendim per emerimin e nje ose me shume te administratoreve te tjere. Ne kete rast emerimi do te behet me nje afat prej tre vitesh financiare, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem.

## NENI 15

Ne rast te emerimit te administratorit jo ortak, ai ne mardheniet me Ortakun dhe me te tretet i ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit te Shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet veprimeve qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe statuti ia japin shprehimisht Ortakut.

Administratori eshte pergjegjes ndaj Shoqerise dhe te treteve per shkelje ligjore, per shkelje te statutit ose faje te kryera gjate administrimit te tij.

## NENI 16
## KONFIDENCIALITETI

Ortaku i Vetem si dhe personat e tjere te pranuar ne shoqeri bien dakort qe ti mos ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe do ti disponoje shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe si dhe planet dhe qellimet e saj per te ardhmen.

## NENI 17
## ORGANI SINDIKAL

Ky organizem do te organizohet dhe do te funksionoje ne baze te ligjislacionit ne fuqi.

# KREU IV
# LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

## NENI 18
## LIBRAT E SHOQERISE

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra:

1. Libri i shoqerise ne te cilin shenohet emri i plote i ortakut, kapitali themeltar.

2. Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te ortakut te vetem.

3.Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit sindikal.

Dy librat e pare mbeten nen kujdesin e ortakurt te vetem, kurse i treti nen kujdesin e organit sindikal.

## NENI 19

f @

## VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTET KONTABAL

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar i cili do te filloje pas regjistrimit te shoqerise ne gjykate si person juridik dhe ne organin tatimor, por do te perfundoje me 31 dhjetor 1997.

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vecanta te hartuara nga ekspertet kontabel te autorizuar nga ortaku, miratohen nga Ortaku i vetem.

Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore do te behet brenda nje afati prej tre muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Veprimtaria e ekspertit ose eksperteve kontabel te autorizuar nga ortaku i vetem do te funksionoje sipas nenit 69 te ligjit Nr.7638, date 19.12.1992.

## NENI 20
## ZGJATJA E AFATIT

Zgjatja e afatit te shoqerise qe eshte percaktuar ne kete statut, mund te vendoset nga Ortaku i Vetem.

## NENI 21
## AKTIVITETI FINANCIAR

Ne çdo mbyllje te çdo viti financiar behet inventari dhe llogaria vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin si dhe hartohet nje raport me shkrim.

Bilancit i bashkengjiten:

a. Nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria.

b. Nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria.

Raporti perfshin gjendjen gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara , veprimtarite e mundshme qe jane zhvilluar nga data e mbylljes se vitit financiar deri ne diten qe eshte hartuar ky raport.

Dokumentet vihen ne dispozicion te ekspertit ose eksperteve te autorizuar dhe ne perfundim miratohen nga ortaku i vetem.

## NENI 22

Fitime neto te shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat e te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise, detyrimet fiskale, sigurimet shoqerore, demtimet, amortizimet, etj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta financimi.Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve,perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante caktohet nga ortaku i vetem ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Ne perputhje me Nenin 213 te ligjit "Per shoqerite tregetare" nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet menjane nje shume me vlere 1/20 e cila destinohet per formimin e nje fondi "rezerve e domosdoshme".

## NENI 23
## PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria prishet me kalimin e afatit te caktuar ne statut dhe per aresye te percaktuara ne ligj. Shoqeria prishet perpara afatit me vendim te Ortakut te vetem.

## NENI 24

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin, si dhe bashkimi i shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit per "shoqerite tregetare"

## NENI 25

Kur shoqeria prishet, ajo kalon ne likujdim; emertimit te dhene te shoqerise ne kete rast i shtohet shenimi : " Shoqeri ne likujdim e siper". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit.

Prishja e shoqerise eshte me pasoja ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregetar.

## NENI 26

Per te perfunduar procesin e likujdimit, Ortaku i Vetem emeron nje ose disa persona si likujdues te cilet perfaqesojne shoqerine. Likujduesi perpilon bilancin financiar, likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe tepericat i kalojne Ortakut te Vetem.

Ne rast se Ortaku i Vetem nuk ka mundesi te emeroje likujdues , ai emerohet nga gjykata.

## NENI 27

Ne perfundim te mbylljes se likujdimit, ortaku i vetem vendos per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullueshmerise, per administrimin e tij nga na e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te likujduesit, si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likujdimit.

Dokumentet e mesiperme miratohen nga Ortaku i Vetem.

## NENI 28

Kur shoqeria likujdohet, pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi u kthehen pronareve.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare i kalojne Ortakut te Vetem pasi te jene bere pagesat kreditoreve.

**KREU IV**
**DISPOZITA TE FUNDIT**
**NENI 29**

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne Kodin e Punes.si dhe rregullave te vena ne kontraten e punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punemarresit.

**NENI 30**

Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi.

Kur mosmarreveshjet nuk zgjidhen ne mirkuptim. kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata .

**NENI 31**

Ky statut eshte hartuar ne 4 kopje. duke patur secila kopje te njejten fuqi ligjore.

**NENI 32**

Ky statut firmoset nga Ortaku i Vetem me vullnetin e tij te lire konform ligjes.

**THEMELUESI**
**RUZHDI KONI**
R.Koni

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA
Nr...435...rep. Nr...192.......Kol.

**V E R T E T I M**

Ne Tirane.sot me daten 26...12.1997. para meje Notere Manushaqe Sharko u paraqit personalisht: Ruzhdi Koni.i biri i Muhametit. i vitlindjes 1963. lindur ne Maminas e banues ne Tirane .me adrese Rruga "Pandi Dardha". p.2. shk.1. ap.1.me certifikate Nr.6-28-7. e dates 02.07.1997. madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar. i cili deklaroi se ka redaktuar jashte zyres se noterise kete statut. me vullnetin e tij te lire e nenshkruan rregullisht para meje dhe une Noter e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R E
MANUSHAQE SHARKO

PULLE TAKSE
20 LEKE
R.SHQIPERISE